



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1029/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, në kontestin tregtar administrativ sipas padisë së paditësit “Sante Farm” LLC me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura “R...” LLC, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2432/19 të datës 13.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.05.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa, e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.2432/19 i datës 13.10.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.2008/19 të datës 09.03.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit Sante Fram LLC me seli në Prishtinë, është anuluar aktvendimi nr.01.3.2.2/6673 i datës 09.08.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.1-2019/1 e datës 13.05.2019 i lëshuar nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese dhe është detyruar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit Sante Farm LLC me seli në Prishtinë, t’ia kthej obligimin doganor shtesë, të paguar në emër të TVSH-

së (8%) shumën prej 2,432.82€, dhe taksës mbrojtëse (100%) në shumë prej 30,410.52€, gjithsejtë shumë prej 32,843.35€ (tridhjetë e dy mijë e tetëqind e dyzet e tre euro, e tridhjetë e pesë cent).

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovet ankesa në tërësi si e bazuar ankesa në ligj, Prishtet aktgjykimi A.nr.2432/19 i datës 13.10.2020 si i pa bazuar në ligj dhe ta le në fuqi vendimin e kontestuar ose t'ia kthej çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/6673 të datës 09.08.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë “Sante Farm” LLC me seli në Prishtinë, me numër fiskal, për rishqyrtimin e aktvendimit 03.1.1-2019-191/1 datë 13.05.2019 të Sektorit të Kontrollës Pas Imprtuese.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, në Prishtinë, që paditësit “Sante Farm” LLC me seli në Prishtinë, t'ia kthej obligimin doganor shtesë, të paguar në emër të TVSH-së (8%) shumën prej 2,432.82€, dhe taksës mbrojtëse (100%) në shumë prej 30,410.52€, gjithsejtë shumë prej 32,843.35€ (tridhjetë e dy mijë e tetëqind e dyzet e tre euro, e tridhjetë e pesë cent). Ndër të

tjera në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar është theksuar se nga administrimi i provave në konflikt administrativ gjykata konstaton se Sektori i Kontrollit Pas-Importues – Dogana e Kosovës, si organ faktik i shkallës së parë, nuk ka provuar të verifikoj dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor të zhdoganuar më DUD-in R5350 të datës 07.02.2019 ZBD Prishtinë. Në arsyetimin e tij, Kontrolli pas-importues të vetmin argument për rivlerësimin e mallit lëndor e bazon në ndryshimin e çmimeve të mallit lëndor me çmimet e mallrave identike të zhdoganuara në vitin 2017, 2018 (DUD-at R58340/02.10.2018, R33882/06.07.2017, R29718/30.05.2018, R37044/30.06.2018). Të njëjtin veprim duke iu shmangur në tërësi obligimit ligjor për të vërtetuar vlerën e transaksionit të mallit lëndor në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, dhe pretendimeve ankimore të paditësit, e paditura me vendimin kontestues nuk shqyrton dhe nuk konteston asnjë dokumentacion përcjellës të mallit lëndor të zhdoganuar me DUD-in R5350 të datës 07.02.2019 të ZBD Prishtinë. Paditësi ka deklaruar në seancën gjyqësore para gjykatës, se Kontrolli pas-Importues – Dogana e Kosovës, gjatë procedurës së kontrollit i ka kërkuar paditësit prova lidhur me vlerën e deklaruar të mallit të importuar nga eksportuesi Bosnalijek- Bosnja dhe Hercegovina, mirëpo nuk është bërë asnjë vlerësim i këtij dokumentacioni nga Kontrolli Pas-Importues. Nga kjo gjendje faktike ku edhe e paditura në procedurën administrative të ankesave, nuk bën vlerësimin e pretendimeve ankimore se rivlerësimi doganor është në kundërshtim me legjislacionin doganor, gjykata konstaton se e paditura nxjerr vendimin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, pa i shqyrtuar të gjitha provat që i ka pasur në disponim. Paditësi ka prezantuar para të paditurës gjatë kontrollit dhe në këtë konflikt administrativ para gjykatës, faturën e mallit doganor nr.95011931 të datës 06.02.2019, pagesën bankare të datës 27.05.2019 ProCredit Bank e realizuar për të njëjtën faturë të mallit, Aneksin e Kontratës së Distribuimit të datës 03.01.2019 e lidhur mes paditësit dhe eksportuesit – shitësit Bosnalijek DD me seli në Sarajevë – Bosnjë dhe Hercegovinë, ku janë listuar çmimet e artikujve të kontraktuar. Nga kjo gjendje faktike e dokumentacionit të paraqitur nga paditësi, të cilat dokumentacione janë në tërësi të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, gjykata konstaton se me të drejtë Zyra e Brendshme Doganore në Prishtinë ka vlerësuar mallin lëndor të deklaruar me DUD-in R5350/07.02.2019, sipas metodës së parë të vlerësimit, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim e Kolegji i Gjykatës së Apelit, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë bindëse që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë, ashtu siç e përcakton neni 33 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmoj se ia ka paguar paditësit – eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-in kontestues, si dhe faturën përcjellëse të mallit lëndor, gjë që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Të paditurës i është dhënë mundësia që t'i paraqes të gjitha provat dhe faktet bindëse që dëshmojnë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, por e njëjta vetëm se ka pretenduar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por pa e mbështetur pretendimin e saj në dispozitat ligjore konkrete. Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilën ka vlerësuar se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës faturën e mallit doganor

nr.95011931 të datës 06.02.2019, pagesën bankare të datës 27.05.2019 ProCredit Bank e realizuar për të njëjtën faturë të mallit, Aneksin e Kontratës së Distribuimit të datës 03.01.2019 e lidhur mes paditësit dhe eksportuesit – shitësit Bosnalijek DD me seli në Sarajevë – Bosnjë dhe Hercegovinë, ku janë listuar çmimet e artikujve të kontraktuar. Gjykata në këtë konflikt administrativ pranon fakte se para dhe pas nxjerrjes së aktit administrativ përfundimtar në procedurën administrative, në anën tjetër Ministria e Shëndetësisë nxjerr Udhëzimin Administrativ nr.02/2019 për Rregullimin e Çmimit të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale, me të cilin akt normativ rregullon çmimet e produkteve medicinale në tregun vendor, dhe Vendimet e datës 30.04.2020 me të cilat akte kjo Ministri përkatëse rregullon dhe përcakton çmimet e reja të artikujve medicinal të ngjashëm me artikujt, vlera e të cilëve është konstatuar nga e paditura Kontrolli Pas- Importues -Dogana e Kosovës. Nga këto çmime që ka përcaktuar Ministria e Shëndetësisë në vendin tonë (artikuj douclav 875mlg, 125mlg, 500mlg, 125mlg 2.56€), janë çmime që dallojnë nga ato të rivlerësimit nga e paditura e cila këtë artikull e ka rivlerësuar me çmimin prej 4.00€ (forma tabelare në arsyetimin e vendimit të Kontrollit pas Importues).

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË-Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1029/22, me datë 10.05.2023

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri